# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-462385**
VERSIONI 1

> **Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | "Rastësia e çuditshme"/ Dy ditë para emërimit të Hysenit, Agasi themeloi me 1 mijë lekë kompaninë që mori miliona tek AKSHI |
| ADRESA | `https://versus.al/aktualitet/rastesia-e-cuditshme-dy-dite-para-emerimit-te-hysenit-agasi-themeloi--i47005` |
| BURIMI | versus.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 23 shtator 2026, 18:45:41 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 23 shtator 2026, 08:25:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `aa8ed02d4fe6406266f9e71db96920b76286cd72b3f40840138bd15100bba560` |
| TEKSTI | `47c2ac98321873440f3d06cfa77733f5d704980ccecb0dac3f5c0bb40e6789fe` |
| PAMJA | `0197796be195fcbfb8e658e82f50b61c12c1b74ddd63679d0381c4fd38d8857f` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `9ec0dadb05b384c50b361fe891b703ce852a5c8ff9b7ef9638cfebab9102c029` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/9ec0dadb05b384c50b361fe891b703ce852a5c8ff9b7ef9638cfebab9102c029`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Live Updates

[“Na kanë bërë shumë gjëra o shpirt"/ Vlora Hyseni dhe Ergys Agasi mbi 500 mesazhe në 2 muaj në Signal. Shefja e SHISH i dha materiale sekrete, merret në pyetje nesër në GJKKO!]

23 Shtator 2026, 13:50

^ekstrakti^

Na ndiqni edhe në



Created and monetized by

AKTUALITET / 23 Shtator 2026, 10:25

# "Rastësia e çuditshme"/ Dy ditë para emërimit të Hysenit, Agasi themeloi me 1 mijë lekë kompaninë që mori miliona tek AKSHI

Kompania e Agasit nisi të merrte tendera shtetërorë me miliona euro përfitime menjëherë sapo u regjistrua në QKB.

Shkruar nga Versus



**Vlora Hyseni, Ergys Agasi**

Zhvillimet e reja rreth aksionit të djeshëm të SPAK që tronditi vendin pasi për herë të parë në histori u arrestua në detyrë shefja e shërbimit të inteligjencës, vijojnë të nxjerrin detaje të reja rreth lidhjes së Agasit me institucionin e SHISH.

- 

  ### [U vetëdorëzua në kufi, Vlora Hysenit i komunikohen akuzat në polici! Dyshohet se Agasi lëvizte me makinën e saj]

  23 Shtator, 08:48

Së fundmi, është vënë re një rastësi e dyshimtë që lidh Agasin me Vlora Hysenin, shefen e shkarkuar nga SHISH e cila aktualisht ndodhet nën arrest shtëpiak. Me 15 mars të vitit 2023, Ergys Agasi themeloi kompaninë "EA Solution" me një kapital prej 1 mijë lekësh dhe veprimtari të orientuar totalisht drejt informatikës.



| | |
|---|---|
| Administrator: | Ina Ciko |
| Objekti i Veprimtarisë: | Zhvillim, implementim dhe mirëmbajtje të sistemeve dhe programeve në fushën e teknologjisë së informacionit.Projektim, ndërtim dhe mirëmbajtje në fushën e telekomunikacionit si rrjete WAN/LAN, sisteme sigurie Web-site etj.Shërbim akses interneti.Shërbime konsulence dhe trajnime profesionale në fushën e teknologjisë se informacionit dhe telekomunikacionit.Sistem informatik për regjistrimin fillestar të pronave, përmirësimin dhe përditësimin e të dhënave.Zhvillim dhe implementim të sistemeve te informacionit gjeografik (GIS), regjistrim të pasurive të paluajtshme, planifikim urban, hartografi dhe matje topogjeodezike.Hostim i faqeve të aplikacioneve.Regjistrimi dhe Administrimi i Emrave dhe Domain-eve ne¨n .AL dhe ne¨n domain-et .gov.al, .mil.al, .edu.al, .com.al, .org.al dhe .net.al" |
| Emërtime të tjera Tregtare: | EA Solution shpk |
| Forma ligjore: | Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar SH.P.K |

Ergys Agasi - 100%

Ndarja e pjesëve në bazë të gjinisë së zotëruesve!

Stats

Ndarja e pjesëve në bazë të gjinisë së zotëruesve!

Ortak femra % 0

Ortak meshkuj % 100

Vlere kuota/aksione meshkuj :

1000

| | |
|---|---|
| Viti i Themelimit: | 15/03/2023 |
| Rrethi: | Tirane |
| Shteti ku vepron: | Shqiperi |
| Origjina e Kapitalit: | Shqiperi |
| Kapitali Themeltar(Lekë): | 1 000,00 |

Follow Us On

Twitter

Facebook

Vetëm dy ditë më vonë më 17 mars të atij viti, Rama njoftoi se kishte propozuar emrin e Vlora Hysenit për drejtimin e SHISH, propozim që u dekretua nga presidenti Bajram Begaj më 3 prill.

Kur kanë kaluar mbi 3 vite nga kjo datë, dje SPAK bëri publike të dhëna tronditëse që ngrenë dyshimet se Agasi dhe Hyseni janë në të njëjtën linjë hetimi sa i takon sistemit të tenderave të AKSHI-t ku kompania e Agasit përfitoi me miliona euro duke bashkëpunuar me Ermal Beqirajn dhe drejtoreshën e AKSHI-t Mirlinda Karçanaj. Kompania e biznesmenit kontravers e themeluar me 1 mijë lekë, nisi menjëherë të merrte tendera shtetërorë me vlera të majme.

Sa i takon "rastësisë së çuditshme" të propozimit të Hysenit dhe Agasit ka shumë dritëhije që nxisin dyshime të ndryshme. Karçanaj ndodhej më herët në Tiranë si këshilltare e Ramës dhe sigurisht që mendimi për të propozuar emrin e saj në krye të SHISH nuk mund të ketë lindur pikërisht në mëngjesin e 17 marsit. Duke qenë se sipas SPAK Hyseni ka ndihmuar Agasin gjatë kohës së tij në kërkim, njohja mes tyre mund të ketë lindur shumë më herët. **Versus.al**

Tags:

ergys agasi vlora hyseni skandali i akshi-t

Poll



AKTUALITET

**Akuzohet se trafikoi 50 ton drogë nga Ekuadori drejt Evropës, policia zbardh veprat penale të Shpëtim Aliut**

23 Shtator 2026, 20:32

^ekstrakti^



AKTUALITET

**'Kumbari' i grupeve të Dizdarit, Çopjave e Gjikës, arrestohet në Rusi Shpëtim Aliu**

23 Shtator 2026, 20:21

^ekstrakti^





AKTUALITET

**[“Presim sjellje të përgjegjshme shtetërore”, familjet e ish-krerëve të UÇK-së kërkojnë qëndrim të unifikuar ndaj vendimit të Hagës]**

23 Shtator 2026, 20:14

^ekstrakti^



AKTUALITET

**[Të dielën ‘Tiranathlon’/ Ja rrugët ku do të kufizohet qarkullimi imjeteve dhe itinerari i linjave urbane]**

23 Shtator 2026, 20:10

^ekstrakti^



AKTUALITET

**[Aksident i dytë brenda ditës në Durrës, makina përplas qytetarin me monopatinë]**

23 Shtator 2026, 19:32

^ekstrakti^



AKTUALITET

**[Kallas takime të ndara me Kurtin dhe Vuçiç në OKB: Progresi në dialogun Kosovë-Serbi, kusht për integrimin në BE!]**

23 Shtator 2026, 19:21

^ekstrakti^





AKTUALITET

**Dy vatra zjarri në Vlorë dhe pranë liqenit të Viroit në Gjirokastër. Era përhap flakët, digjen koshere me bletë**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.